



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN  
UNIVERSITY "KADRI ZEKA" GJILAN  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
[www.upgj.org](http://www.upgj.org)

Rektori  
Prof. Asoc.Dr. Bajram Kosumi

Nr. Ref. 0A/381      Data 10.05. 2016

## **BREGULLORE**

**mbi hartimim e punimit të diplomës për bachelor**

Gjilan, 2016

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 16 paragrafit 3 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr. 04/L-037 dhe në bazë të nenit 110 pika 1,2,3,4 dhe 5 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka”, Senati i UKZ në mbledhjen e tij të rregulltë të mbajtur me datën 8.01.2016 , miratoi këtë:

## **RREGULLORE**

### **mbi hartimim e punimit të diplomës**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1.**

- a) Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e paraqitjes, hartimit dhe e vlerësimit të punimit të diplomës në Universitetin Publik të Gjilanit “Kadri Zeka” në Gjilan.

##### **Neni 2.**

- a) Për marrjen e diplomës mbi studimet e përfunduara në Universitetin “Kadri Zeka” (më tutje universitetit) është e nevojshme që studenti, përveç ECTS kredive të akumuluar (që fitohen me një numër të provimeve të dhëna) dhe kryerjes së obligimeve të tjera, të hartojë edhe punimin e zgjedhur të diplomës, i cili poashtu vlerësohet me ECTS kredi.
- b) Studenti duhet që së bashku me provimin e diplomës të akumuloj së paku 180 ECTS kredi në drejtimin tre vjeçar, kurse ato katër vjeçar duhet ti kenë 240 ECTS.
- c) Punimi i diplomës parimisht bëhet nga lëndët mësimore të cilat i ka kryer studenti gjatë studimeve në fakultet.

##### **Neni 3.**

- a) Punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
- b) Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
- c) Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës për bachelor nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.

##### **Neni 4.**

- a) Në punimin e diplomës studenti duhet të tregojë, dituri dhe aftësi teorike që ka arritur gjatë kohës së studimeve, në përvetësimin e temës së dhënë, se temën e ka punuar me metodën që i përgjigjet punimit, se e njej literaturën dhe dinë ta përdor atë në mënyrë profesionale dhe të pavarur.
- b) Tema e diplomës paraqet punën e pavarur dhe profesionale të një problemi ose detyre të caktuar teorike, metodologjike ose profesionale.
- c) Në programin e hartimit të punimit të diplomës, studenti është i detyruar të bashkëpunojë me mentorin.

#### **Neni 5.**

- a) Me propozim të Dekanit të Fakultetit përkatës, miratohet regjistri i temave të diplomës të cilat mund t'i marrin studentët. Tema e diplomës fillimisht i propozojnë mësimdhënësit të fakultetit.
- b) Senati i UKZ-së, me vendim të veçantë mund të vendos mbi numrin e temave të diplomës që një mësimdhënës mund të jetë mentor gjatë një viti akademik.
- c) Regjistri i temave të diplomës, të miratuara nga Këshilli i Fakultetit, shpallen në tabelën e shpalljeve në fillim të vitit akademik.

#### **Neni 6.**

- a) Studentët e UKZ-së mund të propozojnë tema të tjera të cila nuk janë në regjistrin e temave për punimet e diplomës, çështje tematike këto që janë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e kohës në fushat përkatës, por gjithnjë në marrëveshje me mësimdhënësin e lëndës.

#### **Neni 7.**

- a) Studenti temën e diplomës mund ta paraqet me minus një provim të pa dhënë
- b) Studenti, mund të bëjë kërkesën për punimin e temës së diplomës nga fillimi i semestrit të fundit të studimeve.
- c) Temën e diplomës studenti e paraqet në formularin e veçantë në të cilin përveç shënimeve të studentit paraqitet: titulli i punimit, lënda mësimore të cilës i përket, përmbajtja e temës, emri i mentorit dhe data e paraqitjes së temës. Në pjesën e dytë në formular shkruhen: data e lejimit të diplomës, data e dorëzimit të diplomës, data e mbrojtjes së diplomës, komisioni për vlerësim dhe mbrojtje. Të gjitha të dhënat vërtetohen nga Dekani i Fakultetit. Krejt në fund të formularit është konstatimi I referentit se studenti ka fituar të dejtën për të paraqitur temën e diplomës.
- d) Në procedurën e përcaktimit të temës së diplomës, studenti është i obliguar që bashkë me temën dhe përmbajtjen e punimit të caktoj edhe litreturën dhe materialet e tjetër me të cilat do të shërbehet me rastin e hartimit të punimit të diplomës.
- e) Fletëparaqitja e temës së diplomës merret në shërbimin e studentëve. Temën e zgjedhur nga studenti duhet të nënshkruaj mentori. Mentori me pelqim të Dekanit të Fakultetit mund të propozoj dy anëtar të komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e temës.
- f) Fletëparaqitjen të cilën e ka nënshkruar mentori, studenti e dorëzon në shërbimin e studentëve për të bërë regjistrimin.
- g) Studenti nëse ka arsy bindëse dhe të justifikueshme mund ta ndërroj temën njëherë. Në këtë rast studentin në afat të arsyeshëm e të mjaftueshëm kohor duhet të lajmëroj mentorin dhe shërbimin e studentëve dhe në fletëparaqitje shënohet që studentin ka hequr dorë me kohë nga tema e paraqitur.
- h) Paraqitja e temës së diplomës i dërgohet Dekanit të fakultetit përkatës për shqyrtim. Me propozim të Dekanit, këshilli I Fakultetit lejon ndërrimin e punimit të diplomës, cakton mentorin e temës dhe formon komisionin për vlerësim dhe mbrojtje. Mentori as në këtë rast e as në raste tjera nuk mund të zgjidhet kryetar i komisionit.
- i) Në rastin kur studentin zgjedhë temën e diplomës nga regjistri i temave të diplomës të miratuar nga Këshilli i fakultetit, ai mund ta punoj atë.

### **Neni 8.**

- a) Tema e lejuar e diplomës nuk mund të mbrohet para 30 ditësh nga dita e lejimit
- b) Student është i obliguar që temën e diplomës me kopertina, ta dorëzoj në 5 kopje, në shërbimin e studentëve, së paku 7 ditë para ditës së mbrojtjes.
- c) Tema e lejuar duhet të mbrohet në afatin prej 6 muajve, pas këtij afati tema e lejuar anulohet dhe student duhet të zgjedh temë të re.

### **Neni 9.**

- a) Temën e përfunduar të diplomës student e lidhë dhe e dorëzon në shërbimin e studenteve në afatin e përcaktuar me neni 8.
- b) Shërbimi i studentëve e bënë regjistrimin e diplomës në protokoll dhe të njëjtin, në tri kopje, së bashku me fletëparaqitjen e temës ia dërgon komisionit për vlerësim dhe mbrojtje, pasi të konstatoj se student I ka dhënë gjitha provimet sipas planit mësimor dhe ka kryer obligimet tjera të parapara për të mbrojtur temën e diplomës.

### **Neni 10.**

- a) Pas pranimit të punimit të diplomës, komisioni në afat prej 10 (dhjetë) ditësh bënë vlerësimin e punimit me shkrim të diplomës dhe nëse vlerësimi është pozitiv, në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit, e cakton datën e mbrojtjes me gojë.

### **Neni 11.**

- a) Në qoftë se punimi është vlerësuar pozitivisht, kandidati mund të hyjë mbrojtjes së tij.
- b) Studentët janë të detyruar që ta mbrojnë punimin e diplomës para komisionit tre anëtarësh (mentorit dhe dy anëtarëve).
- c) Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe mbahet në kohën që e cakton mentori në marrëveshje me anëtarët e komisionit. Mentori për kohën e mbajtjes së mbrojtjes e lajmëron Koordinatorin për ECTS ose Administratën e Universitetit të cilët e lajmërojnë studentin.

### **Neni 12.**

- a) Në mbrojtjen e punimit të diplomës verifikohet dija teorike dhe praktike si dhe aftësia studentit që të merr mbrojtje dhe argumentojë përfundimet vetanake në lidhje me materien të cilën e ka përpunuar në punim.
- b) Procedura e mbrojtjes së punimit të diplomës është si vijon:
  - » Kryetari i Komisionit e hap procedurën e mbrojtjes;
  - » Kandidati e prezanton problematikën themelore të punimit, metodat me të cilat është shërbyer dhe rezultatet të cilat i ka arritur në punim. Prezantimi zgjatë rreth 10 minuta.
  - » Anëtarët e Komisionit i bëjnë pyetje kandidatit.
  - » Çdo anëtar mund t'i parashtrojë më së shumti 3 pyetje.
  - » Pas parashtrimit të pyetjeve, kandidati ka të drejtë të mendojë deri në 5 minuta, pas së cilës kohë duhet të përgjigjet në pyetje.
  - » Pasi që të përgjigjet në të gjitha pyetjet e parashtruara, Komisioni e shqyrton kualitetin e punimit të diplomës, paraqitjen gojore të kandidatit mbi punimin dhe përgjigjet e tij në pyetjet e parashtruara si dhe në bazë të kësaj përcakton notën përfundimtare të punimit të diplomës.
  - » Notat e punimit të diplomës janë: shkëlqyeshëm (10 ose 9), shumë mirë (8), mirë (7), mjaftueshëm (6) dhe pamjaftueshëm (5).

### Neni 13.

- a) Në rast të mungesës të një anëtarit të Komisionit në mbrojtje të punimit, Dekani mund të emërojë zëvendësin.

### Neni 14.

- b) Nëse mentori dhe anëtarët e Komisionit vijnë deri te përfundimi se kandidati e ka mbrojtur me sukses punimin ose nëse kanë ardhur deri te konstatimi se në këtë nuk ka pasë sukses, ia komunikojnë kandidatit vlerësimin (notën) drejtpërdrejtë pas mbrojtjes.
- c) Kandidatit ia komunikon notën publikisht Kryetari i Komisionit.

### Neni 15

- a) Nëse tema e diplomës ose mbrojtja e temës së diplomës është vlerësuar me notë të pamjaftueshme nga ana e komisioni, studenti duhet që të plotësoj temën e diplomës dhe të eliminoj të metat sipas udhëzimeve të kryetarit të komisionit, në afatin prej tridhjetë ditësh prej komunikimit të notës. Procedurat e mbrojtjes së diplomës përsëritet.
- b) Nëse tema e diplomës, e përsëritur, vlerësohet me notë pozitive, do të zhvillohet procedura e mbrojtjes në mënyrën e njëjtë.
- c) Studenti të cilit tema e diplomës i është vlerësuar me notë të pamjaftueshem në nderkohë mund të kërkoj të nderroj temën e diplomës dhe mentorin.

### Neni 16.

- a) Në mbrojtjen e punimit të diplomës verifikohet dija teorike dhe praktike si dhe aftësia studentit që të merr mbrojtje dhe argumentojë përfundimet vetanake në lidhje me materien të cilën e ka përpunuar në punim.
- b) *Procedura e mbrojtjes së punimit të diplomës është si vijon:*
- » Kryetari i Komisionit e hap procedurën e mbrojtjes;
  - » Kandidati e prezanton problematikën themelore të punimit, metodat me të cilat është shërbyer dhe rezultatet të cilat i ka arritur në punim. Prezantimi zgjatë rreth 10 minuta.
  - » Anëtarët e Komisionit i bëjnë pyetje kandidatit.
  - » Çdo anëtar mund t'i parashtrojë më së shumti 3 pyetje.
  - » Pas parashtrimit të pyetjeve, kandidati ka të drejtë të mendojë deri në 5 minuta, pas së cilës kohë duhet të përgjigjet në pyetje.
  - » Pasi që të përgjigjet në të gjitha pyetjet e parashtruara, Komisioni e shqyrton kualitetin e punimit të diplomës, paraqitjen gojore të kandidatit mbi punimin dhe përgjigjet e tij në pyetjet e parashtruara si dhe në bazë të kësaj përcakton notën përfundimtare të punimit të diplomës.
  - » Notat e punimit të diplomës janë: shkëlqyeshëm (10 ose 9), shumë mirë (8), mirë (7), mjaftueshëm (6) dhe pamjaftueshëm (5).

### Neni 17.

- a) Me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës përpilohet procesverbalë mbi provimin e diplomës, i cili përmban këto shënime:
- » Numrin rendor (numrin e diplomës)
  - » Emrin dhe mbiemrin e studentit
  - » Numrin amzë
  - » Datën e regjistrimit të parë
  - » Statusin e studentit
  - » Tema e punimit të diplomës

- » Vëllimi i punimit të diplomës (numri i faqeve, kapitujve, tabelave, figurave etj.)
  - » Mentori i punimit të diplomës
  - » Nota në punimin e diplomës
  - » Vërejtjet eventuale mbi punimin dhe mbrojtjen
  - » Emrat dhe mbiemrat si dhe nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit për mbrojtjen e punimit
- b) Procesverbalin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit dhe Dekani.
- c) Procesverbali mbi mbrojtjen e punimit të diplomës i dorëzohet Administratës ku deponohet dhe ruhet.

#### **Neni 18.**

- a) Studenti, i cili me sukses e mbron punimin e diplomës, fiton thirjen BAÇELOR për drejtimin përkatës mësimor.
- b) Studenti, i cili e kryen me sukses punimin e diplomës, i lëshohet certifikatë në emër të diplomës mbi përfundimin e studimeve 3 apo 4 vjeçare baçelor të drejtimit gjegjës apo drejtimin gjegjës mësimor dhe diploma origjinale.
- c) Formën e certifikatës së diplomës dhe të diplomës origjinale, e përcakton me vendim të veçantë Universiteti sipas Udhëzimit Administrativ nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.
- d) Diploma i dorëzohet studentit në mënyrë solemne.
- e) Administrata e fakultetit mbanë evidencën e studentëve të diplomuar.

### **Metodologjia e hartimit të punimit të diplomës**

#### **Neni 19.**

- a) Me rastin e hartimit të punimit të diplomës, studenti duhet të ketë kujdes për përmbajtjen e domosdoshme dhe cilësinë formale të punimit.
- b) Në cilësi formale hyjnë: stili, gjuha, drejtshkrimi, faqet e punimit, klasifikimi dhe radhëtja e përmbajtjes, citimi i burimeve me fusnota, regjistri i rregullt i literaturës së përdorur sipas radhës së alfabetit të autorëve dhe shënimet e tjera të literaturës, regjistri dhe pasqyra e dokumentacionit.
- c) Në cilësinë e përmbajtjeve të punimit hyjnë: respektimi konsekuent i temës, aplikimi korrekt i metodës së analizës dhe sintezës si dhe metodave të tjera gjegjëse shkencore, argumentimi i qëndrimeve, shprehja e rregullt e qëndrimeve, konkludimeve, propozimeve etj.
- d) Në qoftë se studenti gjatë studimeve ka bërë një ose më shumë punime të cilat për nga përmbajtja dhe vëllimi i përgjigjen punimit të diplomës, ai punim (ose punime) mund të pranohet si punim i diplomës dhe vazhdon procedura normale e mbrojtjes.

#### **Neni 20.**

- a) Punimi i diplomës shkruhet me kompjuter në letër të formatit A4 (21 X 29.7 cm) dhe përbëhet nga:
  - » kopertinat (shtojca nr. 1)
  - » fleta e pastër
  - » fleta e brendshme kryesore (shtojca 2)

- » përmbajtja
  - » pjesa hyrëse
  - » përpunimi i temave sipas kaptinave
  - » përfundimi (përfundimet)
  - » regjistri i literaturës dhe burimeve të tjera që janë shfrytëzuar.
- b) Literatura e cekur p.sh. përdoret në këtë mënyrë:
- » Librat (Mbiemri, emri i autorit, titulli i librit, botuesi, vendi i botimit, viti i botimit).
  - » Revistat (titulli, artikulli, autori, botuesi, vendi, viti, numri i revistës, nr. faqeve).
  - » Të tjera (ligje, rregullore etj).
  - » regjistri i shtojcave (nëse ekzistojnë në punim).
- e) Punimi i diplomës në studime duhet të përfshihet në minimum 30 faqe duke e përdorur teknikën si në vijim:
- » Margjinat e majta dhe të djathta 30 mm;
  - » Margjinat lartë-poshtë 25 mm;
  - » Paragrafët të renditur në rreshta të gjerë (Line spacing 1.5 lines);
  - » Fonti që përdoret në shkrim - kalibri të madhësisë 11 pts me renditje në të dy anët (justify);
  - » Fonti që përdoret për tituj – Arial Bold 14 pts me renditje në mes (Center);.
  - » Fonti që përdoret për nëntituj – Arial Bold 13 pts renditje në mes (Center).
  - » Fonti që përdoret për fusnota – Calibri 9 pika
  - » Fonti që përdoret për përshkrim të tabelave, diagrameve, fotove etj. – Times New Roman Italic 10pts.

#### Neni 21.

- a) Në pjesën tekstuale të temës studenti është i detyruar të udhëzojë në literaturën e shfrytëzuar dhe në burime tjera të shënimeve me të cilat është shërbyer.
- b) Çdo punim i huaj, pavarësisht se a është cituar drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, ose që është interpretuar, duhet të theksohet.
- c) Pjesët e cituara dhe të interpretuara duhet të shënohen me anë të fusnotës me numër, nën faqen e njëjtë, në fund të faqes. Në fusnota duhet shënuar:
- » *nëse bëhet fjalë për libër: mbiemri dhe emri (ose iniciallet) e autorit, titulli i veprës, emri i botuesit, vendi i botimit, viti i botimit dhe numri i faqes së cituar;*
  - » *nëse bëhet fjalë për revistën: mbiemri dhe emri i autorit, titulli i artikullit, emërtimi i revistës, viti i botimit, numri i revistës dhe numri i faqes nga e cila është nxjerrë citati.*
- d) Literatura e cila është shfrytëzuar me rastin e hartimit të punimit theksohet në fund të punimit. Regjistri i literaturës sajohet sipas radhës alfabetike të mbiemrave të autorëve.
- e) Të gjitha tabelat dhe paraqitjet grafike në tekst duhet të jenë të shënuara me numra dhe të kenë emrin dhe burimin e vetë.
- f) Çdo tabelë, fotografi, grafik etj, duhet të jetë e përshkruar në atë mënyrë që të mund të kuptohet dhe automatikisht të përdoret pa pjesën e tekstit.

#### Neni 22.

- a) Punimi i diplomës detyrimisht mbështjelllet në kopertina të forta (trash), në kopertina shënohet:
- » UNIVERSITETI “Kadri Zeka”- Fakulteti i Edukimi
  - » (Stema e universitetit )
  - » (TITULLI I PUNIMIT TË DIPLOMËS)

- » Punim diplome
  - » Mentori: Emri i mësimdhënësit
  - » Studenti: Emri i studentit
  - » Gjilan, muaji viti
- a) Në faqën e dytë (të brendshme) të punimit shënohen këto të dhëna:
- » *UNIVERSITETI "Kadri Zeka" - Fakulteti i Edukimit*
  - » *PUNIM DIPLOME*
  - » *Lënda nga e cila është bërë punimi*
  - » *Titulli i punimit*
  - » *Emri dhe mbiemrit i studentit*
  - » *Satusi i studentit*
  - » *Numri i amzës*
  - » *Drejtimi dhe shkalla e studimit*
  - » *Mentori i punimit*
  - » *Gjilan, muaji dhe viti*


**Neni 23.**

- a) Punimi i diplomës detyrimisht mbështjelllet në kopertina të forta (trashë) dhe parimisht kopertina me ngjyrë e llogës së Universitetit.

**Neni 24.**

- b) Kjo rregullore hynë në fuqi në ditë e miratimit nga Senati i Universitetit të Gjilanit, dhe nënshkrimin të saj nga Rektori i UKZ-së.

Mdryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen në mënyrën në të cilën është miratuar Rregullorja.



**Rektori**  
**Prof.Asoc.Dr. Bajram Kosumi**



Shembulli 1 Ballina e punimi të diplomës

UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI \_\_\_\_\_

DREJTIMI \_\_\_\_\_



# PUNIM DIPLOME

Emri dhe mbiemri i kandidatit

Gjilan, 2016

Shembulli 2 Faqja e pare e punimi të diplomës

UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI \_\_\_\_\_

DREJTIMI \_\_\_\_\_



Titulli i temës:

PUNIM DIPLOME

Mentori:

Kandidati:

Gjilan, 2016